

INSTITUTI I KURRIKULAVE DHE I STANDARDEVE

PROGRAMI MËSIMOR PËR ARSIMIN FILLOR

LËNDA: Edukim Muzikor

(klasa e pestë)

VITI SHKOLLOR 2008-2009

Tiranë, 2007

1. TË PËRGJITHSHME

Programi i edukimit muzikor për klasën e pestë të shkollës 9-vjeçare, vazhdon të zbulojë dhe zhvillojë përvojën dhe talentin e nxënëve, duke dhënë mundësinë, që nëpërmjet veprimtarive të ndryshme muzikore, të ndërthuret përvoja personale me njohuritë muzikore.

Programi ka një formë dhe një strukturë më të qartë ku përfshihen rubrikat si: synimet e lëndët, linjat e programit, objektivat, njohuritë dhe aftësitë për çdo linjë, shpërndarjen e orëve, metodologjinë e programit dhe vlerësimin. Edhe në këtë program njohuritë muzikore merren dhe rimerren duke gjetur zbatim në praktikën muzikore. Këto njohuri realizohen duke u ndërthurrur nëpërmjet veprimtarive praktikë - artistike në klasë, shkollë ose auditore të ndryshme të shkollës.

Programi zhvillohet në 35 javë mësimore përgjatë gjithë vitit shkollor. Gjithashtu, ky program jep mundësinë që në tema të veçanta muzika të integrohet edhe me lëndë të tjera si: *edukimi figurativ, gjuha amtare, dituri natyre, matematikë, edukim fizik etj.*

2. SYNIMET E LËNDËS

Mësimi i muzikës në klasën e pestë të arsimit të detyruar 9-vjeçar, synon t'i aftësojë nxënësit për të përjetuar dhe për t'u shprehur nëpërmjet muzikës, duke shprehur nëpërmjet saj botën e tyre emocionale. Nëpërmjet këtij programi synohet të zhvillohen më tej aftësitë dhe shprehitë *për të kënduar, për të dëgjuar, për të luajtur, për të krijuar*, si dhe *për t'u shprehur* duke mbajtur qëndrim ndaj muzikës.

Nëpërmjet mësimit të muzikës nxënësi/sja në fund të klasës së pestë do të jetë i/e aftë:

- Të këndojë “Himnin e Flamurit”;
- Të këndojë këngë të thjeshta dhe didaktike për fëmijë, me tematika të larmishme;
- Të këndojë në intonacion dhe emocion;
- Të ndërtojë ritme të thjeshta në kohët 2/4, 3/4, 4/4;
- Të krijojë modele të thjeshta ritmike;
- Të shoqërojë këngët me instrumente të thjeshta ritmike ose melodike, si: *triangolo, tambur, zilka, shkopinj etj.*;
- Të dëgjojë pjesë muzikore të thjeshta, vokale dhe instrumentale;
- Të edukojë më tej aftësinë dëgjimore, duke njohur dhe komentuar me fjalë të thjeshta pjesë të ndryshme muzikore;
- Të përjetojë muzikën, duke shprehur dhe përdorur një terminologji muzikore për këtë nivel.

3. LINJAT E PROGRAMIT

Ky program është i organizuar në 5 linjat e mëposhtme:

1. Këndimi
2. Bazat e arsimimit muzikor
3. Luajtja në instrument
4. Dëgjim muzikor
5. Shprehje dhe krijim muzikor

4. OBJEKTIVAT, NJOHURITË DHE AFTËSITË KRYESORE SIPAS LINJAVE

Gjithsej	35 orë
Kurrikula zyrtare	30 orë
Kurrikula në dispozicion të mësuesit	5 orë

LINJAT	Objektivat	Konceptet dhe aftësitë kryesore	Numri i orëve sipas linjave
LINJA I. Këndimi	<p>Objektivat</p> <p>Në klasën e pestë në këtë linjë nxënësi/sja duhet të jetë në gjendje:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të këndojë saktë “Himnin e flamurit”; • të këndojë këngë të thjeshta për fëmijë me tematikë të shumëllojshme, didaktike, të krahinës, të cilat duhet të jenë brenda oktavës do-do²; • të zhvillojë më tej shprehitë vokale gjatë të kënduarit; • të këndojë solo; 	<p>ritmi,</p> <p>intonacioni,</p> <p>frymëmarrja,</p> <p>diksioni,</p> <p>interpretimi,</p>	17 orë

	<ul style="list-style-type: none"> • të këndojë në grup (ansambël/kor); • të këndojë kanone në kohë të thjeshta; • të interpretojë këngët në mënyrë shprehëse, duke respektuar shenjat e ngjyrimit; • të shprehë mendimin rreth muzikës që këndojnë, ose të këngëve të ndryshme si: (këngë për fëmijë, shqiptare, të huaja apo të krahinës). 	këndimi solo, kor.	
LINJA II. Bazat e arsimimit muzikor	<p>Objektivat Në klasën e pestë në këtë linjë nxënësi/sja duhet të jetë në gjendje:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të shkruajë shenjën e notës (forma: koka dhe bishti); • të shkruajë saktë shenjën e notës në vija dhe hapësira; • të ligjërojë modele ritmike 2/4, 3/4, 4/4; • të krijojë modele të thjeshta ritmike 2/4, 3/4, 4/4 (përmes shenjave apo simboleve, rrahjeve të duarve, përmes goditjeve me shkopinj etj); • të përcaktojë <i>vetitë e tingullit (i ulët – i lartë; i gjatë – i shkurtër; karakterin;)</i> në një pjesë të thjeshtë muzikore. 	ritmet e thjeshta 2/4, 3/4, 4/4, shenja e notës, vetitë e tingullit, modele – krijime të ndryshme në kohët e thjeshta.	5 orë
LINJA III. Luajtja me instrument	<p>Objektivat Në klasën e pestë në këtë linjë nxënësi/sja duhet të jetë në gjendje:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të ndërtojë instrumente të thjeshta me goditje, duke ndjekur udhëzimet (<i>tamburi, triangolo, etj.,</i>); • të krijojë ritme të ndryshme nëpërmjet instrumenteve me 	instrumentet ORF, ritmet e thjeshta - luajtja e tyre, shoqërimi me instrumente ORF.	3 orë

	<p>goditje;</p> <ul style="list-style-type: none"> të shoqërojë këngët ose meloditë e ndryshme me instrumente ORF. 		
LINJA IV. Dëgjimi muzikor	<p>Objektivat Në klasën e pestë në këtë linjë nxënësi/sja duhet të jetë në gjendje:</p> <ul style="list-style-type: none"> të përdorë magnetofonin; të dallojë <i>shenjat e ngjyrimit (p, mf, f)</i> në këngët që këndon; të ekzekutojë <i>shenjat e ngjyrimit</i> gjatë këndimit; të njohë disa instrumente ritmike dhe melodike si: <i>fyellin, çiftelinë, dajren, glockenshpilin.</i> 	<p>shenjat e ngjyrimit, dëgjimi me vëmendje i fragmenteve ose pjesëve muzikore, përdorimi i magnetofonit.</p>	2 orë
LINJA V. Shprehje dhe krijim muzikor	<p>Objektivat Në klasën e pestë në këtë linjë nxënësi/sja duhet të jetë në gjendje:</p> <ul style="list-style-type: none"> të përjetojë muzikën nëpërmjet arteve të tjera: vallëzim, vizatim, poezi etj.; të shpjegojë me fjalë të thjeshta, emocionet e muzikës që dëgjojnë me karakter të ndryshëm; të përcjellë mendimet dhe emocionet e tij/saj rreth muzikës që dëgjon; të krijojë vargje mbi një melodi. 	<p>karakteret muzikore: <i>të dhimbshme, të gëzuara, të qeta, marshe,</i> shprehja përmes arteve të tjera.</p>	3 orë

KURRIKULA E LIRË

Kurrikula e lirë (deri në 15% e sasisë totale të orëve) është lënë për t'i krijuar hapësira të nevojshme iniciativës dhe krijmtarisë së shkollës dhe të mësuesit për të përmbushur sa më mirë nevojat dhe interesat e nxënësve në përputhje me objektivat e programit zyrtar të miratuar nga MASH.

Statusi i saj është sa i detyrueshëm aq edhe fleksibël. Është i detyrueshëm sepse duhen zhvilluar deri në fund të vitit shkollor. Është fleksibël sepse shpërndarja përgjatë vitit dhe mbushja me material mësimor është lënë në dorë të mësuesit në bashkëpunim me drejtorinë arsimore, drejtorinë e shkollës dhe me mësuesit e tjerë të shkollës.

Për realizmin e saj me sukses mund të përdoren burime të ndryshme, por gjithmonë të bëhet kujdes të punohet për arritjen e kërkesave të programit.

Grumbullimi i fakteve apo të dhënave të ndryshme kulturore, historike, gjeografike, demografike, mund të kthehen në një burim të vlefshëm për të organizuar orë mësimore interesante.

Organizimi i *veprimtarive artistike, vizitat në qendra të ndryshme kulturore muzikore janë në shërbim të një objekti të caktuar të programit; organizimi i konkurseve brenda klasës; organizimi i një koncerti, biseda për kompozitorë apo artistë popullorë, lojëra të ndryshme muzikore.* Përforcimi i njohurive i shoqëruar me metoda e strategji që fuqizojnë si të nxënët ashtu edhe mësimdhënien, janë disa veprimtari rekomanduese për rubrikën e orëve të lira.

Për mbushjen efikase të një pjese të orëve të lira mund të bashkëpunohet edhe me mësuesit e lëndëve të tjera, duke hartuar paraprakisht një plan të përbashkët disa orësh që, shfrytëzon lidhjet konceptuale ndërlëndore dhe aspektet kroskurrikulare. Nxënësve u jepet një detyrë e cila përfshin njohuri ndërlëndore dhe u shërbën arritjes së objektivave të programeve të disa lëndëve dhe objektivave kroskurrikulare.

Shpërndarja dhe varieteti i veprimtarive, duke ju gjetur vendin e duhur përgjatë vitit mësimor, është një element i rëndësishëm i zbatimit me sukses të rubrikës të orëve të lira.

Kujdes duhet bërë që orët e lira të mos shpërdorohen duke i shfrytëzuar për qëllime rutinë të cilat nuk sjellin risi të reja në kurrikulin shkollor.

6. INTEGRIMI

Ky program jep mundësinë që në tema të veçanta, edukimi muzikor të integrohet edhe me lëndë të tjera meqë mësuesi është njohës i mirë i tërësisë së programit të klasës.

Nxënësit mësojnë të ndërtojnë lidhjet ndërmjet muzikës dhe edukimit figurativ, leximit, edukimit fizik, matematikës, gjeografisë duke kuptuar rëndësinë e muzikës si burim kënaqësie dhe si mënyrë komunikimi brenda një kulture dhe kulturave të tjera.

Integrimi në linjën e këngës bëhet me: gjuhën amtare (duke interpretuar dhe bërë koment sipas një tematikës që kanë këngët), edukatën qytetare (kur kënga mund të trajtojë çështje të tilla si sjellja, familja, shoqëria etj), edukimin fizik (kombinimi i lëvizjeve trupore me muzikën që ata këndojnë), diturinë e natyrës (zëri dhe tingulli).

Integrimi në linjën e BAM, bëhet me matematikën (rreth thyesave, kuptimi dhe krahasimi i thyesave), edukimin figurativ (përdorimi i formave në shkrimin e formës së notave muzikore).

Integrimi në linjën e DM, bëhet me diturinë e natyrës (dallimi i tingujve nga njëri tjetri apo i zërave, apo mjediset).

Integrimi në linjën e SHKM bëhet me edukimin fizik (harmonizimi i lëvizjeve me rrahjet ritmike), (harmonizimi i lëvizjeve trupore me muzikën), me leximin (shkrimi i bukur dhe me ndjenjë i një pjese muzikore që i pëlqen), edukimi figurativ (përdorimi i ngjyrave, vijave, formave për të përcjellë një mendim).

Aspektet kros-kurrikulare janë patur parasysh në shtjellimin e rubrikave të programit. Gjatë zbatimit të tij një vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet:

- çështjeve të mjedisit, ndotjes dhe mbrojtjes së tij;
- kulturës së komunikimit (aftësimi të nxënësve për të kuptuar dhe zbatuar informacionin e shkruar në jetën e përditshme;
- mjeteve të informimit si media dhe masmedia, internetit;
- përdorimit të teknologjive të informacionit, mjeteve audio-vizive, kompjuterit;
- përdorimit të gjuhës së huaj;
- edukimit për të drejtat e njeriut;
- çështjeve të barazisë gjinore, etnike, kulturore, racore, fetare;
- atdhedashurisë (informacion kulturor - artistik, ekonomik, social, historik, gjeografik);
- globalizmit.

7. METODOLOGJIA E ZBATIMIT TË PROGRAMIT

Në këtë program ashtu si edhe në programet e viteve të kaluara një vend shumë të rëndësishëm zë formulimi i objektivave, si dhe përcaktimi i metodave që do të përdoren nga përdorusit e këtij programi, për të qenë sa më të sukseshëm. Përzgjedhja e metodave mësimore bëhen, në përputhje me veçoritë e moshës së nxënësve, të përmbajtjes së temave të ndryshme mësimore apo të bazës materiale mësimore që ka në përdorim. Shumë e rëndësishme është që, përdoruesit e këtij programi të krijojnë një mjedis mësimi, i cili do t'i nxisë dhe do t'i ndihmojë nxënësit për të zbuluar dhe për të zhvilluar aftësitë, shprehjet, prirjet dhe vlerat e tyre muzikore më

tej. Gjithashtu, përdoruesit e këtij programi duhet të organizojnë veprimtari të larmishme praktike sa të jetë e mundur, pasi shumë aftësi të përcaktuara në program duhet të arrihen nëpërmjet pjesëmarrjes në to.

Ky program mundëson zhvillimin e modeleve të ndryshme ritmike dhe i drejton nxënësit në përjetimin e kohës 2/4, 3/4, 4/4, përmes veprimtarive konkrete, individualisht dhe në grup. Nën drejtimin e përdoruesve të këtij programi, nxënësit në këtë nivel rikujtojnë dhe përvetësojnë më tej njohuri dhe elemente të reja muzikore, duke zhvilluar kështu aftësitë për të kënduar, për të dëgjuar apo për t'u shprehur, si dhe për të bërë një analizë të këngëve apo të pjesëve muzikore. Niveli i dijeve dhe shprehive të nxënësit, përcaktohet jo vetëm nga përmbajtja e lëndës, por edhe nga zbatimi i udhëzimeve e kërkesave të veçanta që ka çdo klasë.

Edhe në këtë klasë do të mësohen këngë në përshtatje me moshën për nga:

- shtrirja (ambitusi) do-do dhe nga përmbajtja,
- vlerat didaktike: të tematikat dhe karakterit fëmijor (*natyrën, familjen, shkollën, punën, argëtimin etj.*) me karakter të larmishm muzikor (*vallëzues, marsh, të qeta*) apo edhe të krahinës.

Këngët në këtë klasë në përgjithësi serviren nga teksti i edukimit muzikor për këtë nivel, gjë që lehtëson punën e përdoruesit të këtij programi. Ato duhet të zgjidhen nga hartuesit e teksteve, në përshtatje me kërkesat e bazave të arsimimit muzikor për edukimin e ndjenjës ritmike dhe melodike, si dhe në përputhje me psikologjinë moshore dhe mundësitë e realizimit, nga ana vokale e fëmijëve. Orët e këndimit realizojnë edhe kërkesat e linjës së bazave të arsimimit muzikor. Prandaj këndimi dhe bazat e arsimimit muzikor zhvillohen duke u ndërthurur njëri me tjetrën gjatë orës mësimore. Lënda e edukimit muzikor duhet të përqendrohet tek:

1. Edukimi i ndjenjës ritmike të nxënësve. Dukuritë ritmike përjetojnë në formë konkrete dhe më pas arrihet zbatimi i tyre praktik. Përdoruesit rikujtojnë njohuritë e marra rreth ritmit, duke sjellë në klasë modele të thjeshta ritmike (2/4, 3/4, 4/4) e duke i zhvilluar ato me nxënësit. Gjithashtu gërshetimi i modeleve të sjella apo ushtrimeve me ritmet e thjeshta në shoqërimin e këngëve është i domosdoshëm.

2. Edukimi i ndjenjës melodike. Përdoruesit duhet të zhvillojnë ndjenjën melodike përmes të kënduarit të këngëve, shembujve të thjeshtë melodikë, ose përmes dëgjimit muzikor.

3. Edukimi i shprehive të kënduarit shikohet i pandarë nga aftësitë e tjera në edukimin muzikor. Përdoruesit punojnë për të zhvilluar shprehitë e kënduarit përgjatë vitit përmes:

- rikujtimin të kërkesave gjatë kënduarit,
- zhvillimit të saktë të ndjenjës ritmike,
- intonimit të saktë të këngëve apo pjesëve muzikore.

4. Edukimi me instrumentet dhe marrëdhëniet me to. Shoqërimi i këngëve apo pjesëve të ndryshme muzikore me instrumente me goditje apo dhe ORF bën që këto instrumente të krijojnë lidhje të afërta me artin muzikor dhe zhvillojnë njëkohësisht ndjenjën ritmike të nxënësve. Instrumentet ORF melodike apo ritmike, shtojnë interesin për lëndën, si dhe i ndihmojnë nxënësit më mirë drejt edukimit të ndjenjës ritmike.

5. Edukimi i shprehive gjatë dëgjimit. Dëgjimi i këngëve ose pjesëve të thjeshta muzikore, vazhdon të zhvillojë tek nxënësit njohuri më të plota rreth muzikës, duke i edukuar ata me dëshirën për të dëgjuar. Dëgjimi është mënyra kryesore nëpërmjet të cilit nxënësit vihen në marrëdhënie me muzikën. Nga njohuritë që ata kanë tashmë rreth *ritmeve të thjeshta 2/4, 3/4, 4/4, tingujve, karakterit*, ata e përjetojnë muzikën jo më në mënyrë spontane, por duke e kuptuar dhe bërë vlerësimin me fjalë të thjeshta.

Përdoruesit e këtij programi vazhdojnë punën për kultivimin e ndjenjës së të dëgjuarit të nxënësit, duke përdorur gjithashtu *formën e bisedës*, ku sqarohen dhe shpjegohen karakteri i pjesës, elementet muzikore, si: vetitë e tingullit, ritmin, karakterin etj.; rinjohja e instrumente muzikore përmes dëgjimit, duke dalluar timbrin e tyre, apo edhe njohja me instrumente të tjera muzikore. Gjithashtu, është e domosdoshme që përdoruesit e këtij programi duhet të kultivojnë te nxënësit ndjenjën kritike dhe vlerësuese kështu ata mësohen të mbajnë qëndrim, duke përdorur një fjalor të thjeshtë muzikor.

8. Vlerësimi

Vlerësimi është një proces, i cili jep një informacion të domosdoshëm e të mjaftueshëm për të verifikuar e për të matur përvetësimin e njohurive dhe të shprehive nga nxënësit.

Vlerësimi në klasën e pestë bëhet me notë. Vlerësimi i nxënësve në këtë lëndë të bëhet përmes përfundimeve që arrin nxënësi/sja gjatë procesit mësimor, vetëm ose në grup nga veprimtaria praktike, d.m.th. përmes *të kënduarit, të luajturit, të dëgjuarit, të analizuarit të pjesëve muzikore* etj. Vlerësimi bëhet në atë ç'ka nxënësi/sja ka përvetësuar dhe është i/e aftë të bëjë.

Gjithashtu, mësuesi/sja do të ketë si udhëzues edhe dokumentin e standardeve të arritjes për këtë lëndë.